



**VENDIM**  
**Nr. 717, datë 11.11.2022**

**PËR SHPALLJEN E “ZONËS SË  
TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT  
EKONOMIK” DHE ZHVILLUESIT TË  
ZONËS ME VENDNDODHJE  
NË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 9, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14/1, të vendimit nr. 646, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave e të kriterëve të përzgjedhjes së zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” (TEDA), Tiranë, të territorit me sipërfaqe 342 185 m<sup>2</sup> (treqind e dyzet e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup>, pjesë të zonave kadastrale nr. 3866, nr. 2105 dhe nr. 1867, në Tiranë, të përbërë nga parcelat me numrat e pasurive dhe sipërfaqet përkatëse, sipas listës dhe genplanit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes e të daljes së “Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” (TEDA), Tiranë, përcaktohen në genplanin, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Veprimtaritë, që do të zhvillohen në “Zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” (TEDA), Tiranë, janë të llojit:

- a) industria e automobilave;
- b) industria e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT);
- c) industria e pajisjeve elektronike;
- ç) industria farmaceutike;
- d) industria agropërpunuese;
- dh) industritë prodhuese;
- e) industri të tjera në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4. Periudha e funksionimit të “Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” (TEDA), Tiranë, është 35 vjet, me të drejtë përsëritjeje deri në 99 vjet.

5. Zhvillues i “Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” (TEDA), Tiranë, shpallet Bashkia Tiranë.

6. Masat mbështetëse të përfituara nga Bashkia Tiranë, si subjekt përfitues i statusit “Investim/investitor, procedurë e veçantë”, bazohen në vendimin nr. 1/8, datë 15.7.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike.

7. Për pjesët e sipërfaqes së “Zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” (TEDA), Tiranë, që janë pronë private, të bëhet shpronësimi dhe/ose kompensimi, sipas ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**



ZONA TEKNOLOGJIKE E ZHVILLIMIT EKONOMIK (TEDA) TIRANË,  
GENPLAN I ZONËS

